



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:187051

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05395704

C.nr.1767/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtare Njomëza Berisha, me bashkëpunëtorin profesional B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.N. me numër personal nga fshati komuna e Rahovecit, të cilën me autorizim e përfaqëson av.A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 2,653.56 euro, jashtë seancës, më datë **29.02.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.N. nga fshati komuna e Rahovecit, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, **DETYROHET** e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 24.08.2018 deri më datë 31.07.2021 apo për 36 muaj (për çdo muaj shumën prej 51.03 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë—405.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **1,837.08 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 24.08.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përkatësisht shuma prej **816.48 euro**, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 24.08.2018 apo për 16 muaj (për çdo muaj shumën prej 51.03 euro).

III. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja S.N. nga fshati komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 2,653.56 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse pranë SHFMU “Dy Dëshmorët” në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Meqenëse paditësja është e licencuar dhe e ka kualifikimin e mësimdhënësit në nivelin bachelor me diplom fakulteti, në bazë të nenit 7 të kontratës kolektive të datës 18.04.2017, të njëjtit i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 27% të pagës bazë, qka e paditura këtë shtesë e paguan pjesërisht. Paditësja realizon pagën bazë prej 405.00 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 27% e kësaj page apo shuma prej 109.35 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë në shumën prej 58.32 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 51.03 euro, që nga muaji prill i vitit 2017. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditëses, të detyrohet e paditura që në emër të diferencës së pagesës shtesë për kualifikim dhe atë për 9 muaj të vitit 2017, 12 muaj të viteve 2018, 2019 dhe 7 muaj të vitit 2021, e në shumën e përgjithshme prej 2,653.56 euro, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësja nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditëses. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja S.N. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë SHFMU “Dy Dëshmorët” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër të protokollit 43/2015 të datës 20.10.2015, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura mësimdhënëse, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht i

njëti ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 307, e datës 18.10.2010 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës nr. 43/2015 të datës 20.10.2015, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësi përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësi përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro, mirëpo meqë paditësja ka kërkuar kompensimin në emër të kualifikimit apo licencimit në lartësi prej 27% mbi pagën në lartësi prej 405.00 euro, gjykata llogaritjen e 27% e ka bërë mbi këtë pagë, e cila del të jetë në shumën prej 109.35 euro në muaj, pamvarësisht faktit që nga provat që gjenden në shkresat e lëndës (konkretisht lista e pagave) është vërtetuar se paga bazë e paditëses është 421.00 euro, kjo bazuar në nenin 2.1 të LPK-së. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 36 muaj, nga data 24.08.2018 e deri më datë 31.07.2021, në shumë të përgjithshme prej **1,837.08 euro** ($36 \times 51.03 = 1,837.08$ euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 24.08.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 24.08.2021, ndërsa kërkesa e saj ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 e deri më datë 24.08.2018. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 16 muaj apo në shumën prej 816.48 euro, ndërsa paditësja ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësi sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitivë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtrës të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësen e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1767/2021, më datë 29.02.2024

Gjyqtare
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.